

Pas debatit të gjerë dhe harmonizimit të qëndrimeve të të gjitha grupeve parlamentare Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2003, miratoi këto

### **REKOMANDIME**

1. Kuvendi rikonfirmon mbështetjen e tij për Rezolutën për të drejtat dhe kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe të refugjatëve të datës 7. qershor 2002 dhe e njeh mesazhin e udhëheqësve të institucioneve të Kosovës lidhur me kthimin e të zhvendosurëve.
2. Kuvendi konsideron se kthimi i të zhvendosurve paraqet një çështje humanitare dhe respektim të lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe kërkon që ky proces të mbrohet nga implikimet dhe keqpërdorimet politike.
3. Kuvendi rikonfirmon përcaktimin që Kosova të ndërtohet si shoqëri demokratike që ofron kushte për barazi të plotë të të gjithë qytetarëve të saj pa dallime dhe privilegje.
4. Kuvendi angazhohet që procesi i kthimit të të zhvendosurve të jetë në baza fullnetare në pronat dhe shtëpitë e tyre.
5. Kuvendi konsideron se integrimi i të gjithë qytetarëve në kuadrin e të gjitha institucioneve dhe strukturave të shoqërisë së Kosovës do të ndihmojë procesin e kthimit të të zhvendosurve.
6. Kuvendi angazhohet për krijimin e një klime tolerante të mirëbesimit e të sigurisë për të ndihmuar procesin e kthimit dhe foton të qytetarët e Kosovës që të ndihmojnë këtë proces.
7. Kuvendi konsideron se mbështetja financiare ndërkombëtare për rregullimin e infrastrukturës së nevojshme, zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, paraqet një hap të rëndësishëm në procesin e kthimit të të zhvendosurve.
8. Kuvendi i Kosovës kërkon që kthimi i të zhvendosurve të mos kufizohet në baza etnike por të përfshijë të gjithë qytetarët e Kosovës të zhvendosur gjatë luftës brenda dhe jashtë territorit të Kosovës.
9. Kuvendi i Kosovës do të përcjellë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe kërkon nga institucionet e Kosovës të të gjitha niveleve që të punojnë për realizimin e këtyre rekomandimeve.

Prishtinë, më 10. korrik 2003.